

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Asambleja e OKB, ministri i Jashtëm rus sulmon Evropën: Pengon negociatat e paqes me Ukrainën
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/asambleja-e-okb-ministri-i-jashtem-rus-on-evropen-pengon-negociatat-e-p-i588703
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 11:12:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 11:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d6970bf66fe51e27b69d0e5df1a9e8890eaa12ab571f66c314781e72c8083
TEKSTI	0f1ab0edeaad2de4cd543f034286fa40db7bde53d4004e4d4f1c56f7d6db1c45
PAMJA	b7c25fd6e7eb2a67f97d4a3d0a699db44758bf3bc761770adcceaab15b86b23c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d3b92b96e79e054297df5524f16fd8c098285a6f165bed61b52466942e1fd00c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdf5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d3b92b96e79e054297df5524f16fd8c098285a6f165bed61b52466942e1fd00c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

1 e [Asambleja e OKB, ministri i Jashtëm rus sulmon Evropën: Pengon negociatat e paqes me Ukrainën](#)Mundesi e re per gjetjen e Rajmonda Kotorrit: Emisioni italian publik fundit

Asambleja e OKB, ministri i Jashtëm rus sulmon Evropën: Pengon negociatat e paqes me Ukrainën



27 Shtator 2026, 13:10Bota TEMA



Rusia është ngjitur sërish në podiumin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, dhe sërish ka drejtuar akuza ndaj kontinentit të vjetër. Fajin e kemi ne evropianët, thotë "ujku i vjetër" i diplomacisë ruse, ministri i Jashtëm Sergej Lavrov, nëse nuk po arrin të varrosët sëpata e luftës në Ukrainë: "Evropa po bën gjithçka të mundshme për të penguar negociatat e paqes, për të cilat administrata Trump është e interesuar".

Ka fjalë për të gjithë, por veçanërisht për një: Gjermaninë, e cila "nuk i ka marrë mësimet e Luftës së Dytë Botërore". Pikërisht Berlinit i kushton pjesët më të ashpra të fjalimit të tij, e megjithatë pikërisht në atë drejtim vjen hapja më befasuese: shtrëngimi i duarve, në një sallë anësore, mes Lavrovit dhe ministrit të Jashtëm gjerman Johann Wadephul, përpara një takimi po aq të shkurtër sa edhe të papritur mes dy qeverive që kanë marrëdhënie tejet të këqija.

Përballë Asamblesë, Lavrovi është jashtëzakonisht i ashpër dhe kërcënues. Por përtej deklaratave, figurat kryesore kanë nisur sërish të lëvizin dhe Trumpi, i zhytur në krizën e Lindjes së Mesme, rikthehet të ushtrojë presion: "E dini çfarë do të doja të bënin? Të gjenin një marrëveshje. Dua që Zelensky të arrijë një marrëveshje me Putinin dhe dua që Putini të arrijë një marrëveshje me të", në "një të ardhme jo të largët: ndoshta do të arrijnë një marrëveshje përpara dimrit të plotë".

Por optimizmi i presidentit harron një protagonist: Evropën. Në një vit e gjysmë përpjekjesh, planet e tij të papranueshme për Kievën, lidhur me mënyrën se si duhet përfunduar lufta duke i përjashtuar evropianët nga tryeza e negociatave, nuk kanë kaluar dhe pikërisht këtu Lavrovi e thellon sulmin: "Në Ukrainë po ndërmerren veprime të papërgjegjshme për të frenuar Rusinë. Shtetet e Bashkuara, referenca është për administratën e mëparshme, shkatërruan sistemin e sigurisë evropiane dhe krijuan në Kiev një regjim rusofob. Përfundimi vazhdon të furnizojë me armë regjimin ukrainas" për t'i "shkaktuar Rusisë një disfatë strategjike", por "nxitësit e luftës" do të përfundojnë "në një qorrrok strategjik". Dhe premtori: "Objektivat e operacionit tonë të posaçëm ushtarak do të arrihen dhe kërcënimet ndaj sigurisë sonë do të eliminojnë".

Në të njëjtën linjë me akuzat e zakonshme, të enjten ai i dorëzoi sekretarit të përgjithshëm Guterres një raport me titullin "Trashëgimtarët e Goebbelsit: falsifikimi i ngjarjeve të Buchas dhe inskenimet e përgjakshme të regjimit të Kievit".

Por pak përpara këtij sulmi të ashpër, drejtuesit e diplomacive të Moskës dhe Berlinit ishin shtrënguar sërish duart, siç nuk kishte ndodhur që përpara pushtimit. Njëzet minuta në një sallë të vogël, me delegacionet përkatëse, por me dyer të mbyllura dhe pa asnjë deklaratë të përbashkët.

Zyrtarisht, takimi rezultoi pa ndonjë rezultat, ndërsa Moska u kujdes të theksonte se kishte qenë Gjermania ajo që e kishte propozuar. Wadehul i kërkoi të braktiste “rrugën e rrezikshme të përshkallëzimit”. “Asgjë e re. I thashë: mund të më kishe thënë thjesht “lexo fjalimin tim””, u përgjigj Lavrovi.

Por fakti që Berlioni i kërkoi Moskës një takim, në një fazë kur negociatat po rifillojnë të lëvizin me nismën amerikane, nuk është një detaj i parëndësishëm./La Repubblica

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Shqetësimi i Kanadasë: Rendi global po përjeton "çarje"

11:50 Bota

Rezervuari që ndezi konfliktin në Bregun Perëndimor, palestinezët pa ujë ndërsa izraelitët e kthejnë në vend argëtimi

11:20 Bota / 8 komente

Alarm për eksplozivë pranë bazës ajrore në Britani, arrestohen disa persona, evakohen banorët

10:10 Bota

Sulm vetëvrasës në një pikë kontrolli në Pakistan, të paktën 11 viktima dhe 18 të plagosur

10:00 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.